

Vendim nr. 38 datë 12.07.2023

(V-38/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 29.06.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (N) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES:

NDRIÇIM BALLA

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
KËSHILLI I MINISTRAVE,
PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-891 (104), datë 01.04.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

Shfuqizimi i neneve 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale, si të papajtueshme me Kushtetutën.

BAZA LIGJORE:

Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 27, 28, 29, 30, 31, 33, 42, 43, 116, 122, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 135, 142, 145 dhe 178 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 2 i Protokollit nr. 7 të saj; nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit

nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuetit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave dhe Prokurorisë së Përgjithshme, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*prokuroria*) në datën 09.09.2013 ka regjistruar procedimin penal nr. 4703 të vitit 2013 për ngjarjen e datës 09.09.2013, të ndodhur në qytetin e Tiranës, ku është vrarë shtetasja M.H. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokuroria ka dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë çështjen penale në ngarkim të të pandehurit Ndriçim Balla (*kërkuesi*), me akuzën e kryerjes së veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “ë” dhe 278, paragrafi 4, të Kodit Penal (*KP*).

2. Në përfundim të gjykimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2050, datë 17.09.2014, ka vendosur të deklarojë kërkuetin fajtor për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “ë”, i KP-së dhe dënimin tij me 30 vjet burgim, si dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 4, i KP-së dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, kërkuetit i është dhënë një dënim i vetëm prej 35 vjetësh burgim. Kundër këtij vendimi kërkueti ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2037, datë 23.11.2015, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin nr. 2050, datë 17.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkueti, duke pretenduar se vendimet e gjykatave të faktit janë të

pabazuara në prova dhe në ligj, si dhe në shkelje të normave procedurale penale që garantojnë një proces të rregullt ligjor.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-234, datë 30.03.2017, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit kundër vendimit nr. 2037, datë 23.11.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke arsyetuar se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 14.07.2017 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjyqimit. Sipas tij, vendimet e gjykatave të zakonshme nuk kanë respektuar standardin e arsytimit, pasi nuk kanë dhënë përgjigje të argumentuara për pretendimet e paraqitura në gjykim, çka i ka cenuar edhe të drejtën për t'u dëgjuar dhe të aksesit gjatë gjyqimit. Po kështu, kërkuari ka pretenduar se gjykatat e zakonshme kanë cenuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim, pasi ai është dënuar mbi bazën e provave të marra në kundërshtim me ligjin procedural, duke mos i pranuar kërkesat e tij për deklarimin e tyre si të pavlefshme, si dhe pa marrë në konsideratë disa prova dhe dëshmi të paraqitura nga ai, ndërkohë që gjykata e shkallës së parë e ka zhvilluar gjykimin në mungesë të tij, në një kohë kur ai ka kërkuar shtyrjen e tij për arsye shëndetësore. Në vijim, sipas kërkuarit, është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi gjatë gjyqimit barra e provës i ka kaluar padrejtësisht atij dhe jo palës akuzuese në respektim të rregullave procedurale, por edhe të garancive kushtetuese për këtë qëllim. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e mosdënimit pa ligj, pasi nuk ka zbatuar ligjin penal favorizues për sa i përket veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, për të cilën dispozita e re e KP-së ka parashikuar një dënim më të ulët nga ai që kanë dhënë gjykatat e zakonshme. Së fundi, kërkuari ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, të cilat ishin të tilla që duhet të kishin marrë përgjigje në seancë gjyqësore dhe jo në dhomën e këshillimit, duke i cenuar kështu të drejtën për t'u dëgjuar përpara gjykatës, krahas standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

6. Me vendimin nr. 70, datë 24.10.2017 (vendimi nr. 70/2017) Gjykata ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të kërkesës. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2017-234, datë 30.03.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.”*. Gjykata ka vërejtur se, ndërsa çështja e kërkuarit ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, me vendimin e saj nr. 9, datë 26.02.2016 janë shfuqizuar paragrafët pesë dhe gjashtë të nenit 278 të KP-së, shtuar me ligjin nr. 144/2013, datë 02.05.2013, ndryshuar

me ligjin nr. 98/2014, datë 31.7.2014, ndërkohë që pas këtij vendimi, me ligjin nr. 82/2016, datë 25.07.2016, neni 278 i KP-së është riformuluar, duke e ulur masën e dënimit për këtë veprë, ligj i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 151, datë 11.08.2016. Sipas Gjykatës, kërkuesi është dënuar nga gjykatat e faktit bazuar në një dispozitë penale që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, dispozitë e cila ka ndryshuar për sa i përket masës së dënimit gjatë kohës që çështja ndodhej për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, ndaj për këtë arsye ky i fundit duhej ta kishte marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të ligjit penal favorizues dhe fuqisë prapavepruese të tij, pretendim i cili rezultonte i bazuar dhe duhej të pranohej. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata ka vlerësuar të mos ndalej në shqyrtimin e tyre, për sa kohë çështja do të merrej përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta duhet t'u japë përgjigje të arsyetuara dhe në seancë publike pretendimeve të mësipërme të ngritura në rekurs nga kërkuesi (*shih paragrafët 11, 12, 14 dhe 15 të vendimit nr. 70, datë 24.10.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Rishqyrtimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është zhvilluar në seancë gjyqësore. Në përfundim të rishqyrtimit, me vendimin nr. 00-2022-891 (104), datë 01.04.2022, ai kolegji ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa u përket disponimeve për deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 4, i KP-së dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me arsyetimin se ndaj kërkuesit duhet të zbatohet ligji penal favorizues, referuar riformulimit të dispozitës në fjalë me ligjin nr. 82/2016 dhe ndryshimit sërish të saj me ligjin nr. 44/2019. Nga ana tjetër, me këtë vendim, Kolegji Penal ka vendosur edhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit për pjesën tjetër të tij, duke vlerësuar se vendimi i saj për ato disponime është marrë në zbatim të drejtë të ligjit dhe se shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuesit janë të pabazuara.

8. Me kërkesën e datës 15.11.2022 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për pjesën që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit për deklarimin fajtor dhe dënimin e tij për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “ë”, i KP-së. Përveç këtij kërkimi, në objektin e kërkesës ai ka kërkuar edhe shfuqizimin e neneve 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të KPP-së, si të papajtueshme me Kushtetutën.

9. Kolegji i Gjykatës, në datën 08.02.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Fillimisht, seanca plenare për shqyrtimin e kësaj çështjeje është caktuar në datën 30.05.2023, por, për arsye objektive, zhvillimi i saj është shtyrë për në datën 29.06.2023, për të cilën palët janë njoftuar rregullisht.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë, si dhe përmbajtja e neneve 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të KPP-së, cenojnë këto të drejta dhe parime kushtetuese:

A. Për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë:

10.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

10.1.1. *Së drejtës për akses efektiv në gjykatë*, pasi Gjykata e Lartë, duke mos vepruar si një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj, ndonëse ka verifikuar legjitimitimin e palëve, nuk ka verifikuar dhe nuk ka arsyetuar për njoftimin dhe pjesëmarrjen e viktimave të veprës penale në atë proces.

10.1.2. *Së drejtës për të marrë pjesë në gjykim të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur vetë*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuесin përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe as ka urdhëruar shoqërimin e tij, me qëllim që t'i krijohej mundësia për të shprehur interesin për të qenë i pranishëm ose jo në gjykim, për sa kohë ka pretenduar pafajësinë dhe nuk ka hequr dorë nga kjo e drejtë.

10.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka regjistruar seancën gjyqësore me mjete audio sipas udhëzimit të ministrit të Drejtësisë nr. 353, datë 03.09.2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio" (udhëzimi nr. 353/2013). Ajo gjykatë, në seancë, ka shprehur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe rikthimin e çështjes për rigjykim po në të njëjtën gjykatë, por me një tjetër trup gjykues, duke mos specifikuar akuzat dhe disponimin për to. Ndërsa në pjesën urdhëruese të vendimit të shkruar ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe rikthimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën

gjykatë, me një tjetër trup gjykues, vetëm për akuzën “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit” duke lënë në fuqi vendimin e saj për akuzën “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”. Nga ky fakt përforcohet bindja se ajo gjykatë nuk ka qenë as e paanshme, as e pavarur.

10.1.4. *Parimit të mosdënimit pa ligj*, pasi Gjykata e Lartë përmes vendimit të dhënë në kundërshtim me nenin 443, pika 2, të KPP-së, ka shtyrë gjykatën e apelit, që do të rishqyrtojë çështjen, drejt shkeljes së parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të gjykatës së caktuar me ligj, pasi ajo do të bazohet në faktin se kërkuesi është fajtor për të dyja akuzat. Në këtë kuptim, gjykatës së rigjyimit do t’i mbetet si funksion vetëm ricaktimi i dënimit të ri sipas ligjit penal favorizues për sa i përket veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, dhe jo shqyrtimi i themelit të çështjes, duke shkelur nenet 135, 142 dhe 145 të Kushtetutës. Kufizimi i shqyrtimit të çështjes nga gjykata e apelit vetëm në shtesa aritmetike ndaj dënimit të mbetur në fuqi, përbën një dënim pa ligj dhe në kundërshtim me nenin 29 të Kushtetutës.

10.1.5. *Standardit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë është gjykatë e ligjit dhe nuk mund të kryejë funksione që u përkasin gjykatave të faktit, përfshirë caktimin e dënimit për një vepër penale dhe analizën e provave që përcaktojnë faktet mbi të cilat caktohet dënimi, për t’i bashkuar më pas dënimet e dhëna për më shumë vepra penale. Në rastin konkret, gjykata e apelit do të jetë në pamundësi objektive për të zbatuar nenin 55 të KP-së, pasi për këtë çështje Gjykata e Lartë e ka paracaktuar dënimin me 30 vjet burgim.

10.1.6. *Parimit të proporcionalitetit*, pasi Gjykata e Lartë, duke përcaktuar në mënyrë përfundimtare masën e dënimit me 30 vjet burgim për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, me pasojë detyrimin e gjykatës së apelit që në rishqyrtimin e çështjes të kufizohet vetëm në përcaktimin e shtesës aritmetike ndaj pjesës së vendimit të mbetur në fuqi, ka cenuar garancitë kushtetuese të kërkuesit për zbatimin e nenit 57 të KP-së, si dhe të nenit 265 të KPP-së, në raport me nenet 17, 135 dhe 145 të Kushtetutës në drejtim të individualizimit të dënimit rast pas rasti.

10.1.7. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi Gjykata e Lartë nuk mund ta rikthente çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit vetëm për veprën penale “Prodhimi dhe

mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit". Gjatë rishqyrtimit të çështjes, përveç kufizimeve për gjykatën e apelit në drejtim të ricaktimit të masës së dënimit, kërkuesi do të jetë i prezumuar fajtor për shkak të lënies në fuqi të vendimit për veprën penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese". Në këtë mënyrë ai nuk do të mund të pretendojë pafajësinë dhe do të jetë i ekspozuar ndaj pasigurisë juridike dhe heqjes së lirisë në mënyrë të paligjshme. Edhe në gjykimin e mëparshëm procesi është zhvilluar në shkelje të prezumimit të pafajësisë, pasi kërkuesit iu ngarkua barra e provës për të provuar arsyen e njohjes së tij si autor i ngjarjes nga dy dëshmitarë.

10.1.8. *Standardit të arsytimit*, pasi Gjykata e Lartë në vendimin e saj është kufizuar vetëm në evidentimin e shkaqeve të rekursit, por nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuara për pretendimet me natyrë kushtetuese të kërkuesit, çka përbënte detyrim për të gjatë rishqyrtimit të çështjes. Shkeljet janë evidentuar si të tilla edhe në raportin e këshilltarit ligjor të asaj gjykate, i cili ka dhënë mendim si person që ka statusin e gjyqtarit të gjykatës së apelit. Detyrimi për të arsyetuar pretendimet thelbësore ishte edhe më i madh, duke pasur parasysh se kjo i ishte caktuar si detyrë edhe nga Gjykata me vendimin nr. 70/2017. Mungesat në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë e bëjnë atë vendim të pavlefshëm dhe/ose të paligjshëm, si dhe antikushtetues.

10.1.9. *Së drejtës për një gjykim të drejtë, të shpejtë dhe të bazuar mbi prova të ligjshme, të lidhur me të drejtën për mjete ankimi efektive*, pasi Gjykata e Lartë, edhe pas vendimit të rishqyrtimit të çështjes për herë të dytë, ka lejuar shkeljen e së drejtës së kërkuesit për proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta, të cilat kishin pranuar si të mirëqenë hetimin e ngushtë të policisë, pa e zgjeruar atë në drejtim të konflikteve që të dëmtuarit kishin me persona të tjerë. Ndërsa, për sa i përket kërkesës për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të disa provave, ato gjykata duhej të shpreheshin me vendim të ndërmjetëm brenda 15 ditëve nga paraqitja e saj, sipas nenit 110, pika 2, të KPP-së dhe jo në vendimin përfundimtar. Në këtë kuptim, ushtrimi i kontrollit nga oficeri i Policisë Gjyqësore pa një vendim kontrolli, si dhe sekuestrimi i kapeleve janë veprime të paligjshme, pasi procesverbalet përkatëse janë të pavlefshme, sepse nuk janë mbajtur në prani të kërkuesit dhe as në respektim të kërkesave të tjera të KPP-së. Për këtë arsye, provat

e marra përmes atyre veprimeve janë të papërdorshme, ndërsa vendimi i prokurorit për vleftësimin e tyre si të ligjshme, është i pavlefshëm. Po kështu, Gjykata e Lartë ka lejuar shkelje të tjera të gjykatave të faktit, për sa i përket mosmarrjes në shqyrtim të të gjitha provave të lidhura me çështjen (sidomos deklaratimet e 8 dëshmitarëve), mosvlerësimin të provave në favor të kërkuesit (deklaratimet e dëshmitarëve A.G. dhe L.S.), si dhe mungesës së analizës për zhdukjen e materialeve të dobishme për hetimin dhe për motivin që kërkuesi të kryente veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, si element i rëndësishëm, ndër të tjera, edhe për individualizimin dhe përcaktimin e masës së dënimit. Për rrjedhojë, rekursi në Gjykatën e Lartë nuk ka rezultuar mjet ankimi efektiv, përderisa përmes tij nuk janë rivendosur të drejtat e kërkuesit të shkelura nga gjykatat e faktit, çka tregon se gjykatat e të tria shkallëve të gjyqësorit kanë qenë të njëanshme.

10.1.10. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka krijuar kërkuesit mundësinë për të marrë pjesë në gjykim, duke i mohuar mundësinë për t’u njohur me pretendimet e palës tjetër dhe për të parashtruar prapësimet e tij, si aspekte me rëndësi substanciale dhe të domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave në proces. Po kështu, i njëjti pretendim vlen edhe për seancën gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë, në të cilën gjykata, pasi ka deklaruar mungesën e kërkuesit, ka administruar disa prova pa i nënshtruar ato më parë në debat gjyqësor. Edhe për sa i përket këtij pretendimi, Gjykata, në vendimin e saj nr. 70/2017, i ka caktuar detyrë Gjykatës së Lartë për ta trajtuar më vete, pasi është thelbësor për çështjen dhe i natyrës kushtetuese, si dhe për t’i siguruar kërkuesit akses efektiv në atë gjykatë, gjë të cilën kjo e fundit nuk e ka bërë.

B. Për shfuqizimin e neneve 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të KPP-së:

10.2. *Neni 437, pika 3, i KPP-së* bie në kundërshtim me nenin 178 të Kushtetutës, si dhe me nenet 28, 31 dhe 33 të saj, në drejtim të zbatimit të nenit 42 të saj dhe të nenit 6 të KEDNJ-së. Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë ka natyrë të veçantë, pasi pjesëmarrësit duhet të kenë një nivel më të spikatur të njohurive ligjore, por kjo nuk përjashton edhe mundësinë që kërkuesi të mbrohet vetë. Në rastin konkret, prania e tij në atë proces ishte e domosdoshme, duke qenë se ai nuk kishte shprehur në mënyrë të qartë vullnetin për të mos u mbrojtur vetë.

10.3. *Neni 443, pika 2, i KPP-së*, për nga mënyra e zbatimit të tij, ka bërë që Gjykata e Lartë të shkaktojë një situatë të paqartë juridike, duke e ekspozuar kërkuesin ndaj pasigurisë juridike dhe pamundësisë së lirimit të tij në çdo rrethanë, në kundërshtim me nenet 29, 135, 142 dhe 145 të Kushtetutës.

11. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, ka prapësuar në aspektet e mëposhtme:

A. Për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë:

11.1. Kërkuesi nuk legjitimohet për kundërshtimin e vendimit gjyqësor, pasi:

11.1.1. Pretendimi që edhe viktimat e veprës penale duheshin thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore në Gjykatën e Lartë, nuk ka të bëjë me cenimin e të drejtave kushtetuese të tij, për rrjedhojë nuk legjitimohet për mbrojtjen e tyre.

11.1.2. Për sa i përket *shterimit të mjeteve juridike efektive*, duke qenë se, aktualisht, çështja po shqyrtohet në gjykatën e apelit për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit” dhe nuk rezulton që këtë ndarje të çështjeve në kuptim të nenit 93 të KPP-së, si dhe duke qenë se shqyrtimi i çështjes në atë gjykatë, në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, mund të sjellë ndryshime për mënyrën e zgjidhjes së saj në themel, kërkuesi nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës, pasi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

11.1.3. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, duke qenë se kërkuesi, përmes ankimit të tij të datës 05.11.2022, ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 01.04.2022, ai nuk legjitimohet në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi i është drejtuar Gjykatës jashtë afatit ligjor 4-mujor nga data e konstatimit të cenimit.

B. Për shfuqizimin e neneve 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të KPP-së:

11.2. Kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin e nenit 437, pika 3, të KPP-së, në kuptim të nenit 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi ky kërkim ka qenë objekt i një vendimi të mëparshëm të kësaj Gjykate dhe dispozita në fjalë e KPP-së është e pandryshuar që nga momenti i miratimit të saj përmes ligjit nr. 7095, datë 21.03.1995, si dhe për shkak se Gjykata në vendimin nr. 25, datë 30.07.2003 (*vendimi nr. 25/2003*) ka vlerësuar dhe është shprehur edhe në lidhje me të drejtën e

të pandehurit dhe të palëve në proces për t'u mbrojtur vetë, si në procesin civil, ashtu edhe në procesin penal.

- 11.3. Pretendimi për shfuqizimin e nenit 437, pika 3, të KPP-së është haptazi i pabazuar, pasi nuk konstatohet ndonjë lidhje shkakore mes vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme dhe nevojës për ndryshimin e legjislacionit penal për rastin konkret, pasi kjo dispozitë garanton të drejtën e të pandehurit për t'u mbrojtur me anë të mbrojtësit ligjor, për shkak të nivelit të njohjes dhe ekspertizës ligjore që duhet të ketë pala në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, shfuqizimi i kësaj dispozite do të shkaktonte cenimin e sigurisë juridike për ato subjekte që nuk duan të jenë të pranishme në procesin e gjykimit në atë gjykatë. Edhe argumenti se kjo dispozitë, meqenëse është e vitit 1995, ka rënë vetvetiu nga fuqia në bazë të nenit 178 të Kushtetutës, pas miratimit të saj në vitin 1998, është haptazi i pabazuar, pasi: *së pari*, në favor të kushtetutshmërisë së asaj dispozite është shprehur edhe Gjykata me vendimin nr. 25/2003; *së dyti*, referuar rregullit të “prezumimit kundër shfuqizimit të nënkuptuar”, dispozita duhej të ishte shfuqizuar në mënyrë specifike; *së treti*, referuar “rregullit të interpretimit të mëparshëm”, duke qenë se neni 8 i ligjit nr. 7692, datë 31.03.1993 “Për një shtojcë në ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”” është substancialisht i njëjtë me nenin 31 të Kushtetutës (1998), për rrjedhojë kanë ruajtur të njëjtin standard, atëherë edhe neni 437, pika 3, i KPP-së së vitit 1995, i cili ka respektuar ligjin kushtetues të vitit 1993, ka respektuar edhe Kushtetutën e vitit 1998.
- 11.4. Pretendimi për shfuqizimin e nenit 443, pika 2, të KPP-së është haptazi i pabazuar, pasi nuk konstatohet ndonjë argument ligjor i cili mund të përbëjë shkak për kufizimin e të drejtave dhe garancive kushtetuese nga norma juridike në fuqi. Përkundrazi, ajo dispozitë orienton gjykatën në rastin e prishjes së vendimit të një gjykate më të ulët dhe kthimit të akteve për rishqyrtim, që të shprehet se cilën pjesë të tij ka prishur, si një garanci kushtetuese për palën e gjykuar për respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për të pasur një vendim të arsyetuar dhe të qartë. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, në rastin kur Gjykata e Lartë, në zbatim të neneve 441, pika 1, shkronja “c” dhe 443, pika 2, të KPP-së, pasi ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, ka vendosur kthimin e akteve për rigjykim në atë gjykatë, jo domosdoshmërisht në rigjykim çështja fillon nga e para, pasi nëse

në vendimin e prishur ka pjesë të sakta, atëherë Gjykata e Lartë ka detyrimin që të mos ta cenojë atë për ato pjesë, duke e rikthyer çështjen për rigjykim vetëm për pjesën e vendimmarrjes që ka shfaqur probleme ligjore. Edhe argumenti se neni 443, pika 2, i KPP-së është në kundërshtim me nenet 29, 135, 142 dhe 145 të Kushtetutës, nuk qëndron, pasi në dispozitën e kundërshtuar nuk konstatohen elemente të cilat bien ndesh me rregullimet kushtetuese të këtyre dispozitave.

12. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar në aspektet e mëposhtme:

A. *Për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë:*

12.1. Kërkuesi nuk legjitimohet për kundërshtimin e vendimit gjyqësor, pasi:

12.1.1. Për sa i përket *shterimit të mjeteve juridike efektive*, duke qenë se çështja po shqyrtohet në gjykatën e apelit në lidhje me akuzën për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, procesi gjyqësor në këtë fazë e lejon kërkuesin të parashtojë pretendimet e tij dhe të sjellë ndryshime në themelin e çështjes. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt i shqyrtimit kushtetues, nuk është përfundimtar në kuptim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive.

12.1.2. Për sa i përket pretendimit se nuk është respektuar e drejta e viktimës për të qenë e pranishme në seancën gjyqësore në Gjykatën e Lartë, kërkuesi nuk legjitimohet, pasi ai nuk mund të paraqesë pretendime për të drejtat e një subjekti të tretë.

12.1.3. Për pretendimet që lidhen me kufizimet që do të ketë gjykata e apelit dhe pasojat që do të shkaktohen si rezultat i rigjykimit të çështjes për pjesën e vendimit të saj të prishur nga Gjykata e Lartë, kërkuesi është bazuar në hamendësime dhe jo në prova, duke paragjykuar mënyrën e zbatimit të ligjit nga ajo gjykatë, për rrjedhojë ato nuk janë në nivel kushtetues.

12.2. Pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, për shkak se gjykata e apelit do të jetë në pamundësi për të zbatuar drejt ligjin penal material (referuar bashkimit të dënimeve dhe përcaktimit të masës përfundimtare të dënimit), është i pabazuar, pasi janë institute që zbatohen edhe për çështje të mëvetshme dhe të ndara në kohë, të cilat nuk kërkojnë domosdoshmërisht zhvillimin e procesit gjyqësor dhe dhënien e dënimit penal në të njëjtën kohë.

B. *Për pretendimet për nenet 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të KPP-së:*

- 12.3. Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* dhe as *ratione materiae* për shfuqizimin e neneve 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të KPP-së, pasi nuk ka argumentuar se si këto dispozita bien ndesh me Kushtetutën, se si i kanë cenuar të drejtat kushtetuese, si dhe cilat janë pasojat konkrete të pësura nga zbatimi i tyre. Pretendimet e tij janë të natyrës procedurale dhe jo të natyrës kushtetuese, për rrjedhojë kërkuesi nuk përmbush kriterin për rivendosjen e të drejtave të shkelura përmes shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000. Shfuqizimi i këtyre dispozitave nuk ndikon në mënyrën e procedimit dhe disponimit nga Gjykata e Lartë. Po kështu, për sa i përket kushtetutshmërisë së nenit 437, pika 3, të KPP-së, Gjykata është shprehur me vendimin nr. 25/2003, për rrjedhojë kërkuesi nuk mund ta investojë sërish atë, në kuptim të nenit 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000.
- 12.4. Pretendimi për shfuqizimin e nenit 437, pika 3, të KPP-së është i pabazuar, pasi argumentet për kundërshtimin e tij janë të njëjta me ato të paraqitura nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, për të cilat Gjykata është shprehur me vendimin nr. 25/2003 në favor të kushtetutshmërisë së tij. Formulimi i kësaj dispozite është i njëjtë dhe i pandryshuar që nga momenti i miratimit të KPP-së me ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar ai kod më pas. Dispozita nuk bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe, në përputhje edhe me standardet e KEDNJ-së, i garanton plotësisht të pandehurit dhe palëve të tjera mundësinë e pjesëmarrjes aktive në proces. Përfaqësimi me mbrojtës ligjor në Gjykatën e Lartë lidhet me njohjen dhe ekspertizën ligjore që duhet të ketë pala në procesin gjyqësor në atë gjykatë, për rrjedhojë palët nuk mund të jenë protagonistë, pasi u mungon aftësia në këtë drejtim. Në rastin konkret, kërkuesi ka pajisur me akt përfaqësimi një mbrojtëse ligjore, së cilës i ka dhënë të drejtën e mbrojtjes edhe në mungesë të tij. Ai ka pasur dijeni për seancën gjyqësore dhe nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë kërkesë të veçantë për të qenë i pranishëm në atë seancë. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk ka arritur të përcaktojë në nivel kushtetues cenimin real dhe të drejtpërdrejtë të të drejtave dhe lirive themelore nga zbatimi i nenit 437, pika 3, të KPP-së, i cili, në rastin konkret, nuk ka sjellë asnjë ndikim negativ, por ka garantuar standardin e procesit të rregullt ligjor.

12.5. Pretendimi për shfuqizimin e nenit 443, pika 2, të KPP-së është i pabazuar, pasi mbështetet në argumente me natyrë të përgjithshme nga të cilat nuk provohen pasojat negative të ardhura ose të pritshme për të drejtat ose liritë e tij kushtetuese nga zbatimi i normës. Kërkuesi e ka lidhur pretendimin e tij me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka interpretuar dhe zbatuar dispozitën konkrete në çështjen e tij, por jo me përmbajtjen e saj. Kjo vërehet edhe në pretendimin se lënia në fuqi nga Gjykata e Lartë e vendimit të gjykatës së apelit për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, do të ndikojë në cilësimin fajtor të kërkuesit edhe për veprën tjetër penale, për të cilën do të rigjykohet në shkallë të dytë. Edhe argumenti se neni 443, pika 2, i KPP-së është në kundërshtim me nenin 29 të Kushtetutës, nuk qëndron, pasi nga interpretimi teleologjik dhe sistematik i dispozitës së kundërshtuar nuk rezulton se kufizohen të drejta kushtetuese të subjekteve në procesin penal.

13. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, ka prapësuar në aspektet e mëposhtme:

A. Për pretendimet ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë:

13.1. Kërkuesi nuk legjitimohet për kundërshtimin e vendimit gjyqësor, pasi:

13.1.1. Për sa i përket *shterimit të mjeteve juridike efektive*, për sa kohë që procesi gjyqësor është ende në vijim, ai mund të sjellë ose jo ndryshime për themelin e çështjes, për rrjedhojë vendimi që kundërshtohet nuk mund të konsiderohet përfundimtar, në kuptim të këtij kriteri, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

13.1.2. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, vendimi i Gjykatës së Lartë është i datës 01.04.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në datën 05.11.2022, për rrjedhojë nuk ka plotësuar kriterin e afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

13.2. Pretendimet për procedurën gjyqësore në Gjykatën e Lartë dhe argumentet në mbështetje të tyre janë të pabazuara. Kërkuesi në seancën gjyqësore të zhvilluar në atë gjykatë është mbrojtur nga avokati i caktuar prej tij me prokurë, i cili ka qenë aktiv në atë proces. Pavarësisht pretendimit të kërkuesit, Kolegji Penal i asaj gjykate, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, ka deklaruar dispozitivin e vendimit me përmbajtje të njëjtë me atë të vendimit të arsyetuar dhe, po kështu, edhe me përmbajtjen sipas procesverbalit të seancës.

B. Për pretendimin për nenin 437, pika 3, të KPP-së:

13.3. Kërkuesi nuk legjitimohet për kundërshtimin e kësaj dispozite. Në rastin konkret, në respektim të së drejtës së mbrojtjes, Gjykata e Lartë e ka zhvilluar seancën me pjesëmarrjen e mbrojtësit të kërkuesit. Mjeti ligjor, pra ai i përfaqësimit të të pandehurit nga mbrojtësi në seancë gjyqësore, ka qenë në fuqi gjatë kohës që çështja ishte në shqyrtim dhe nuk rezultoi që ai të ketë shprehur kundërshtime në lidhje me kushtetutshmërinë e tij ose me mënyrën e zbatimit të tij. Për rrjedhojë, për këtë pretendim *nuk ka shteruar mjetet juridike efektive*.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Gjykata ka pohuar se bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, krahas vendimit gjyqësor, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: (i) legjitimitimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimitimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) dhe legjitimitimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe

shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete, kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin ai ka qenë palë ndërgjyqëse, si dhe përmbajtjen e neneve 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të KPP-së. Gjykata vë në dukje se, bazuar në nenin 39, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8577/2000 është vendosur thirrja në cilësinë e subjekteve të interesuara të Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit, duke vlerësuar se kanë interes të drejtpërdrejtë në gjykimin kushtetues për kërkimin që lidhet me shfuqizimin e dispozitave në fjalë, për shkak se në procesin ligjvënës ushtrojnë respektivisht kompetencat e propozimit dhe të miratimit të ligjeve. Në këtë kuptim, Gjykata do të ndalet në verifikimin e këtyre kriterëve në mënyrë të pavarur për secilin kërkim të objektit të kërkesës në shqyrtim, duke shqyrtuar vetëm atë pjesë të prapësimeve të Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit që lidhet me kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të KPP-së.

A.1. Për shfuqizimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë

17. Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë kërkuesi ka pretenduar se është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor në disa nga aspektet e tij. Mes të tjerash, ai ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, pasi Gjykata e Lartë, ndonëse ka verifikuar legjitimitimin e palëve, nuk ka verifikuar dhe as nuk ka arsyetuar për njoftimin dhe pjesëmarrjen e viktimave të veprës penale në atë proces.

18. Gjykata vëren se kërkuesi ka qenë palë në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë që ka shqyrtuar çështjen e tij penale, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Penal, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata vëren se, sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese. Për rrjedhojë, në lidhje me pretendimet që kanë të bëjnë me njoftimin e subjekteve të tjera në procesin gjyqësor ku ai ka qenë palë, konkretisht të viktimave të veprës penale, kërkuesi nuk ka legjitimitet *ratione personae*, pasi nuk provon cenimin e ardhur në të drejtat e tij kushtetuese, për rrjedhojë interesin e tij të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e të drejtave të këtyre subjekteve në këtë proces kushtetues. Për më tepër, Gjykata konstaton se gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit të çështjes, ka thirrur në seancë gjyqësore shtetasit F.H. (bashkëshorti i

viktimës së ngjarjes) dhe E.F. (vëllai i saj), të cilët kanë dhënë deklaratimet e tyre për rrethanat e ngjarjes si dëshmitarë okularë (*shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 06.02.2014*). Ndërsa në vendimet e tyre, si gjykata e shkallës së parë, ashtu edhe gjykata e apelit e kanë cilësuar shtetasin E.F. “të dëmtuar” (*shih faqen 15 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; faqen 12 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

19. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 01.04.2022, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, për sa u përket disponimeve për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, duke e prishur atë vetëm për sa u përket disponimeve për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”.

21. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të: i) parimit të mosdënimit pa ligj, pasi funksioni i gjykatës së apelit do të kufizohet në ricaktimin e dënimit të ri për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, sipas ligjit penal favorizues dhe jo shqyrtimi i themelit të çështjes; ii) së drejtës për një gjykatë të caktuar me ligj, pasi gjykata e apelit nuk do të mund të zbatojë nenin 55 të KP-së, pasi për këtë çështje Gjykata e Lartë ia ka paracaktuar dënimin me 30 vjet burgim; iii) parimit të proporcionalitetit, pasi gjykata e apelit do të kufizohet vetëm në përcaktimin e shtesës aritmetike ndaj pjesës së vendimit të mbetur në fuqi; iv) si dhe prezumimit të pafajësisë, pasi kërkuesi, gjatë rishqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, do të jetë i prezumuar fajtor për shkak të lënies në fuqi të vendimit për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”. Sipas tij, për shkak të përfundimeve dhe udhëzimeve të Gjykatës së Lartë dhe detyrueshmërisë së tyre për gjykatën e rigjyqimit, parimet në fjalë do të rezultojnë të cenuara nga gjykata e apelit. Për sa i përket

rishqyrtimit të pjesshëm të çështjes në gjykatën e apelit dhe vendimmarrjes eventuale të saj, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk mund t'i drejtohet me ankim kushtetues individual pa përfunduar procesi në të gjitha shkallët e gjykimit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi, për këto pretendime, që në thelb kanë të bëjnë me procesin gjyqësor që do të zhvillohet në gjykatën e apelit, nuk legjitimohet në këtë gjykim kushtetues, pasi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

22. Ndërsa për pretendimet që lidhen me procesin e zhvilluar nga Gjykata e Lartë në lidhje me atë pjesë të vendimit të saj që është bërë përfundimtar, pra për sa u përket disponimeve në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij, për sa i përket veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, kërkuesi nuk ka mjete të tjera ankimi. Për rrjedhojë, për pretendimet e tij për atë pjesë të vendimit të Gjykatës së Lartë plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

23. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 84, datë 26.12.2017; nr. 80, datë 18.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se, si rregull, data e shpalljes së vendimit të Gjykatës së Lartë do të konsiderohet koha kur vendimi gjyqësor është bërë i disponueshëm për efekt të konstatimit të cenimit dhe ankimit në Gjykatë (*shih vendimet nr. 47, datë 06.07.2015; nr. 13, datë 04.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata konstaton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është i datës 01.04.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 15.11.2022. Bazuar mbi këtë fakt, subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

25. Gjykata vëren se, referuar përgjigjes së kancelarit të Gjykatës së Lartë me shkresën nr. 5457/1 prot., datë 24.10.2022, vendimi ka qenë i disponueshëm për palët në datën 18.07.2022, e cila është edhe data në të cilën kërkuesi ka pasur mundësi të njihet efektivisht me të. Për rrjedhojë, duke vlerësuar se afati ligjor për kërkuesin fillon të ecë nga kjo datë, konsiderohet se ankimi

kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

26. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata thekson se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, por Gjykata mund t’i marrë në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore, duke bërë vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Kërkuesi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të: i) së drejtës për të marrë pjesë në gjykim të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur vetë, pasi nuk iu krijua mundësia për të shprehur interesin për të qenë i pranishëm ose jo në atë gjykim; ii) së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi seanca gjyqësore nuk u regjistrua me mjete audio, duke shkaktuar konfuzion mes dispozitivit të vendimit të shqiptuar në sallë dhe atij të paraqitur me shkrim; iii) së drejtës për një gjykim të drejtë, të shpejtë dhe të bazuar mbi prova të ligjshme, të lidhur me të drejtën për mjete ankimi efektive, pasi Gjykata e Lartë, edhe pas rishqyrtimit të çështjes, ka lejuar shkeljet e gjykatave më të ulëta, të cilat nuk hetuan rrethanat në mënyrë të plotë, por morën si të mirëqenë hetimin e policisë; iv) parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi, duke mos marrë pjesë në gjykim, Gjykata e Lartë i ka mohuar mundësinë për t’u njohur me pretendimet e palës tjetër dhe për të parashtruar prapësimet e tij.

28. Gjykata vëren se, në thelb, argumentet në mbështetje të këtyre pretendimeve nuk janë të natyrës kushtetuese, pasi ato kanë të bëjnë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, të cilat, për nga natyra e tyre, nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës. Për më tepër, për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë në lidhje me mungesën e elementeve subjektive dhe

objektive, të cilat qëndrojnë në themel të parimit të paanshmërisë së gjykatës, në funksion të krijimit të besimit në dhënien e drejtësisë. Ai është njohur me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka paraqitur asnjë pretendim përpara ose gjatë shqyrtimit të çështjes së tij. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk e plotëson kriterin e legjitimitetit *ratione materiae* për këto pretendime.

29. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij në rekurs, sikundër as pretendimeve të paraqitura në kërkesën drejtuar Gjykatës, e cila për to ka disponuar me vendimin nr. 70/2017. Gjykata, duke pasur parasysh thelbin e këtij pretendimi, si dhe faktin se kjo çështje është rigjykuar nga Gjykata e Lartë në bazë të vendimit të Gjykatës nr. 70/2017, çmon ta trajtojë atë të lidhur me standardin kushtetues të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të kësaj Gjykate.

A.2. Për shfuqizimin e neneve 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të KPP-së

30. Gjykata vëren se në objektin e kërkesës kërkuesi ka kundërshtuar edhe përmbajtjen e disa dispozitave të KPP-së, konkretisht nenit 437, pika 3, që parashikon se “*i pandehuri dhe palët private* (në Gjykatën e Lartë) *përfaqësohen nga mbrojtësit*”, si dhe të nenit 443, pika 2, që parashikon se “*kur prishja* (e vendimit të gjykatës më të ulët) *nuk është bërë për të gjitha disponimet e vendimit, Gjykata e Lartë deklaron në dispozitiv se cilat pjesë të vendimit prishen*”.

31. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin e nenit 437, pika 3, të KPP-së, në kuptim të nenit 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi ky kërkim ka qenë objekt i një vendimi të mëparshëm të kësaj Gjykate, e cila, me vendimin nr. 25/2003, ka vlerësuar dhe është shprehur në lidhje me të drejtën e të pandehurit dhe të palëve në proces për t’u mbrojtur vetë si në procesin civil, ashtu edhe në procesin penal. Kjo dispozitë është pjesë e KPP-së dhe e pandryshuar që nga momenti i miratimit të këtij kodi.

32. Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka natyrë penale dhe dispozitat e kundërshtuara të KPP-së rregullojnë procedurat e gjykimit në atë shkallë gjykimi, për rrjedhojë kanë gjetur zbatim edhe në rastin e kërkuesit. Po kështu, këto dispozita nuk parashikojnë nxjerrjen e akteve nënligjore dhe zbatohen drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë në procesin që ajo zhvillon, duke përmbushur në këtë mënyrë kushtin e efektit të drejtpërdrejtë, që parashikohet nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i ligjit nr. 8577/2000. Këto parashikime ligjore janë përdorur nga

Gjykata e Lartë si në drejtim të legjitimitit të palëve në proces (përfaqësimit të tyre), ashtu edhe në lidhje me disponimin e saj për zgjidhjen e çështjes konkrete. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

33. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, kërkuesi nuk legjitimohet për kundërshtimin e nenit 437, pika 3, të KPP-së, pasi, në rastin konkret, në respektim të së drejtës së mbrojtjes, Gjykata e Lartë ka zhvilluar seancën me pjesëmarrjen e mbrojtësit të caktuar nga vetë kërkuesi në atë gjykim. Mjeti ligjor, pra ai i përfaqësimit të të pandehurit nga mbrojtësi në seancë gjyqësore, ka qenë në fuqi gjatë kohës që çështja ishte në shqyrtim dhe nuk rezultoi që kërkuesi të ketë shprehur kundërshtime në lidhje me kushtetutshmërinë e tij ose me mënyrën e zbatimit të tij nga Gjykata e Lartë.

34. Gjykata vëren se pretendimet në lidhje me dispozitat e KPP-së kërkuesi nuk i ka ngritur përpara Gjykatës së Lartë, por ato ngrihen për herë të parë në këtë gjykim kushtetues. Në rastin konkret, kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e dispozitave të KPP-së, të cilat janë të zbatueshme nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi, duke qenë se në rastin e tij nuk ka mjete të tjera juridike efektive në dispozicion, e ka përmbushur edhe këtë kriter.

35. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Në rastin e ankimit kushtetues individual, konstatimi i cenimit, si rregull, nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ, por afati ligjor llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuesin ose, e thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ. Kërkuesi nuk i ka kundërshtuar dispozitat e KPP-së drejtpërdrejt në Gjykatë, por së bashku me vendimin gjyqësor të dhënë në zbatim të tij, ndaj afati ligjor 4-mujor llogaritet nga data që ai vendim është bërë i disponueshëm për palët (*shih paragrafin 27*). Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* për kundërshtimin e dispozitave të KPP-së.

36. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 3, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577/2000, një kusht tjetër për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual lidhet me përmbajtjen e pretendimeve të parashtruara. Gjykata vëren se për llojin e pasojave negative të pësura dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, që kanë të bëjnë me përmbajtjen e pretendimeve,

kontrolli kushtetues është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit të garantuara në Kushtetutë.

37. Sipas kërkesit, neni 437, pika 3, i KPP-së është në kundërshtim me nenet 28, 31 dhe 33 të Kushtetutës, në drejtim të zbatimit të nenit 42 të saj, si dhe të nenit 6 të KEDNJ-së. Sipas tij, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë ka natyrë të veçantë, pasi pjesëmarrësit duhet të kenë një nivel më të spikatur të njohurive ligjore, por kjo nuk përjashton mundësinë që kërkuesi të mbrohet vetë dhe, në çështjen e tij, ai nuk kishte shprehur në mënyrë të qartë vullnetin për të mos u mbrojtur vetë. Po kështu, sipas kërkesit, edhe neni 443, pika 2, i KPP-së është antikushtetues, pasi mënyra e zbatimit të tij nga Gjykata e Lartë, në rastin konkret, ka shkaktuar një situatë të paqartë juridike, duke e ekspozuar atë ndaj pasigurisë juridike dhe pamundësisë së lirim të tij në çdo rrethanë.

38. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet për këtë kërkim, pasi nuk ka argumentuar se si këto dispozita bien ndesh me Kushtetutën, se si ato ia kanë cenuar të drejtat kushtetuese, si dhe se cilat janë pasojat konkrete të pësura nga zbatimi i tyre. Pretendimet e tij janë të natyrës procedurale dhe jo të natyrës kushtetuese, për rrjedhojë kërkuesi nuk ka përmbushur kriterin e rivendosjes së të drejtave të shkelura përmes shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi shfuqizimi i atyre dispozitave nuk ndikon në mënyrën e procedimit dhe të disponimit nga Gjykata e Lartë.

39. Referuar akteve të dosjes gjyqësore, të administruara për nevoja të këtij gjykimi, konstatohet se në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, rezulton se kërkuesi është njoftuar për shqyrtimin e çështjes së tij dhe në seancën gjyqësore të datës 01.04.2022 është përfaqësuar dhe mbrojtur nga avokatja S.Ç., e caktuar prej tij në bazë të aktit të përfaqësimit të nënshkruar në datën 30.03.2022, në prani të drejtorit të IEVP-së, Peqin. Në përfundim të gjykimit, Kolegji Penal ka disponuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, për sa i përket deklarimit fajtor të kërkesit për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 4, i KP-së dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues, si dhe lënien në fuqi të vendimit për pjesën tjetër.

40. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në lidhje me dispozitat e KPP-së (*shih paragrafët 10.2. dhe 10.3.*) janë të natyrës procedurale që, në thelb, lidhen me procesin e gjykimit në Gjykatën e Lartë, për sa i përket respektimit të së drejtës së palës për t’u njoftuar, dëgjuar dhe mbrojtur, si dhe me përmbajtjen e vendimit të saj në rastet e kthimit të akteve

për rishqyrtim, në drejtim të qartësisë së deklaramit në dispozitiv të pjesës së prishur të vendimit të gjykatës më të ulët. Në lidhje me këtë dispozitë kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë në nivel kushtetues cenimin në të drejtat e tij për shkak të mënyrës se si disponon me vendim Gjykata e Lartë. Për më tepër, në lidhje me këtë dispozitë, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se avokati është zëri profesional i të përfaqësuarit dhe, si i tillë, i takon atij të jetë protagonist në seancën që zhvillohet në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 25, datë 30.07.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Për sa më lart, për pretendimet që lidhen me kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 437, pika 3 dhe 443, pika 2, të KPP-së, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë argument që të provojë cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave kushtetuese nga dispozitat në fjalë, për rrjedhojë ai nuk legjitimohet *ratione materiae* për kundërshtimin e tyre.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsytimit të lidhur me zbatimin e detyrueshëm të vendimit të Gjykatës

42. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë në vendimin e saj është kufizuar vetëm në evidentimin e shkaqeve rekursit, por nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese të shprehura në kërkesën drejtuar Gjykatës, të cilat përbënin detyrim për atë gjykatë në rishqyrtimin e çështjes. Shkeljet janë evidentuar si të tilla edhe në raportin e këshilltarit ligjor të asaj gjykate, i cili ka dhënë mendim si person që ka statusin e gjyqtarit të apelit. Detyrimi për të arsyetuar pretendimet thelbësore ishte edhe më i madh, duke pasur parasysh se kjo i ishte caktuar si detyrë edhe nga Gjykata me vendimin e saj nr. 70/2017. Mungesat në arsytimin e vendimit të Gjykatës së Lartë e bëjnë atë vendim të pavlefshëm dhe/ose të paligjshëm, si dhe antikushtetues.

43. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohen individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ai, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr.8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Po kështu, Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale. Efekti detyrues i vendimeve të Gjykatës ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr.78, datë 12.12.2017; nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Gjykata evidenton se me vendimin nr. 70/2017 Gjykata ka vendosur të mos ndalet në shqyrtimin e pretendimeve të kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, së drejtës për t'u dëgjuar dhe së drejtës së aksesit në gjykim, të parimit të kontradiktoritetit dhe parimit të prezumimit të pafajësisë, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar dhe në seancë publike pretendimeve të mësipërme të ngritura në rekurs nga kërkuari (*shih paragrafët 14 dhe 15 të vendimit nr. 70, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Gjykata vëren se pretendimet në rekursin e kërkuarit gjejnë pasqyrim në vendimin e Gjykatës së Lartë. Në rekurs kërkuari ka pretenduar se vendimet e dy gjykatave më të ulëta janë të padrejta, të pabazuara në prova e në ligj, të marra në shkelje të normave procedurale që garantojnë një proces të rregullt ligjor. Sipas tij, gjatë gjykimit janë cenuar rëndë parimet bazë të një procesi të rregullt ligjor dhe konkretisht: është cenuar e drejta e mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të marra në mënyrë të paligjshme, të parashikuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, ndërsa veprimi procedural “i njohjes së personit” është kryer si në shkelje të së drejtës së mbrojtjes, ashtu edhe të parashikimeve ligjore të neneve 171-172 të KPP-së, për pasojë ky akt/veprim është absolutisht i pavlefshëm; është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi barra e provës i takon organit të akuzës dhe gjykata duhet të mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza; është cenuar e drejta për të marrë pjesë personalisht në gjykim, në shkelje të rëndë rregullit procedural sipas nenit 350, pika 1, të KPP-së, pasi seanca e

datës 12.06.2014 është zhvilluar në mungesë të tij, megjithëse ai nuk është paraqitur në gjykim për arsye shëndetësore, duke dërguar për këtë edhe një njoftim me shkrim.

47. Gjykata konstaton se çështja është rishqyrtuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në seancë gjyqësore, ashtu sikurse ka urdhëruar Gjykata në vendimin e saj nr. 70/2017. Po kështu, pretendimet me natyrë kushtetuese në rekursin e kërkuarit, të materializuara edhe në ankimin kushtetues, për të cilat Gjykata ka vlerësuar të mos ndalet në shqyrtimin e tyre, për sa kohë çështja do të merrej përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, jo vetëm gjejnë pasqyrim në vendimin objekt kundërshtimi, por edhe janë analizuar. Konkretisht, për pretendimin në rekurs se kërkuari është dënuar mbi bazën e provave të marra në kundërshtim me ligjin procedural, për sa i përket veprimit procedural të “paraqitjes për njohje” ose sequestrimit të provave materiale, mbi të cilin, më tej, ka mbështetur edhe pretendimin për cenimin e parimit të kontradiktoritetit, të standardit të arsyetimit të lidhur me të drejtën e aksesit dhe të drejtën për t’u dëgjuar, në kërkesën drejtuar Gjykatës, Kolegji Penal është shprehur se gjykatat e faktit kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, duke administruar dhe shqyrtuar në tërësi të gjitha provat që kanë lidhje me këtë procedim, por, në kushtet kur nuk mund t’i çmojë ato, për sa i përket themelit dhe fuqisë provuese të tyre, është kufizuar vetëm në vlerësimin nëse është zbatuar drejt neni 152 i KPP-së nga gjykatat e ulëta. Në këtë drejtim, Kolegji Penal ka vlerësuar se këto pretendime kërkuari *“i ka paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, edhe në ankimin e paraqitur prej tij në gjykatën e apelit, të cilat, edhe pse janë marrë në shqyrtim dhe gjykatat i kanë dhënë përgjigje, drejtësisht, në vendimet respektive, janë ngritur sërish si shkaqe rekursi në Gjykatën e Lartë”* (shih paragrafin 29 të vendimit të Gjykatës së Lartë). Po kështu, për pretendimin në rekurs të cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi gjatë gjykimit barra e provës i ka kaluar padrejtësisht atij dhe jo palës akuzuese, të përsëritur më tej si pretendim edhe në kërkesën drejtuar Gjykatës, Kolegji Penal është shprehur se *“gjykatat e faktit kanë shteruar plotësisht procesin e të provuarit, për pasojë vendimi i fajësisë për dy akuzat në ngarkim të kërkuarit nuk është në kufirin e dyshimit të arsyeshëm. Lidhur me pretendimet për shkelje procedurale përgjatë procesit në gjykatat më të ulëta, ajo gjykatë ka vlerësuar se këto pretendime kërkuari i ka paraqitur si në gjykimin e shkallës së parë ashtu dhe në ankimin e tij drejtuar gjykatës së apelit, të cilat i kanë dhënë përgjigje”* (shih paragrafët 28 dhe 29 të vendimit të Gjykatës së Lartë). Gjithashtu, për sa i përket zbatimit të ligjit penal favorizues, Gjykata e Lartë, në respektim të nenit 29, pika 3, të Kushtetutës, nenit 15, pika 1, të KEDNJ-së dhe nenit 434 të KPP-së, si dhe në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata me vendimin nr. 70/2017, ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit duhet të priset në lidhje me

deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit” në bazë të nenit 278, paragrafi 4, të KP-së, duke qenë se ndaj tij duhet të zbatohet ligji penal favorizues dhe çështja të kthehet për rigjykim në atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues (shih po aty, paragrafët 12 – 19).

48. Vendimi i kundërshtuar në pjesën hyrëse përmban të dhënat e të akuzuarit, akuzën, disponimet e gjykatave më të ulëta dhe shkaqet e rekursit, ndërsa në pjesën arsyetuese ka përfshirë vlerësimin dhe argumentet që e kanë çuar gjykatën në qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Ai nuk rezulton të jetë alogjik dhe të ketë kundërtënie, si dhe plotëson kërkesat për respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka sjellë në vëmendje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, dilte jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

49. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 70/2017 dhe se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me standardin kushtetues të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të kësaj Gjykate, është i pabazuar.

50. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara dhe duhet të rrezohen sipas arsyetimit të mësipërm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 12.07.2023

Shpallur më 31.07.2023

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Ndriçim Balla, me objekt: *“Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-891 (104), datë 01.04.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë me tjetër trup gjykues. Shfuqizimi i neneve 437, pika 2 dhe 443, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale, si të papajtueshme me Kushtetutën.”*, jemi pjesërisht kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi, në vlerësimin tonë, kërkesa duhet të ishte pranuar në drejtim të cenimit të standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrajmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes, rezulton se kërkuari është marrë si i pandehur dhe është gjykuar për kryerjen e veprave penale *“Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”* dhe *“Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”*, të parashikuara nga nenet 79, shkronja *“ë”* dhe 278, paragrafi 4, të Kodit Penal (KP). Në bashkim të dënimeve kërkuari është dënuar me një dënim të vetëm prej 35 vjetësh burgim, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, ndërsa Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin e tij. Kërkuari në vijim i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjyqimit, e cila, me vendimin nr. 70/2017, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë.

3. Në rigjykim, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta kanë shteruar plotësisht procesin e të provuarit në përputhje me ligjin procedural penal në funksion të procesit penal. Ndërkohë në dispozitivin e vendimit të saj, kjo gjykatë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë për sa i përket deklaratimit fajtor të kërkuarit për veprën penale *“Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”*, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i katërt, i KP-së dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë. Në këto kushte, kërkuari i është drejtuar sërish Gjykatës për shfuqizimin edhe të këtij vendimi, duke pretenduar se bazuar në vendimin e Gjykatës së Lartë gjykata e apelit do të kufizohet vetëm në përcaktimin e shtesës aritmetike ndaj pjesës së vendimit të mbetur në fuqi, duke i mbetur si funksion vetëm ricaktimi i dënimit të ri sipas ligjit penal favorizues për sa i përket veprës penale *“Prodhimi dhe mbajtja pa*

leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe jo shqyrtimi i themelit të çështjes. Gjykata e Lartë nuk mund ta rikthente çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit vetëm për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, pasi gjatë rigjykimit, përveç kufizimeve për gjykatën e apelit në drejtim të ricaktimit të masës së dënimit, kërkuesi do të prezumohej fajtor për shkak të lënies në fuqi të vendimit për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”. Gjithashtu në këndvështrim të standardit të arsytimit, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë gjatë rigjykimit nuk është shprehur për shkaqet e ngritura në rekursin me të cilin ishte vënë në lëvizje, për rrjedhojë nuk ka riparuar shkeljet me natyrë kushtetuese, në zbatim të detyrave të dhëna me vendimin nr. 70/2017 të Gjykatës.

4. Shumica, duke theksuar se për pretendimet në lidhje me atë pjesë të vendimit të Gjykatës së Lartë që ka disponuar për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, ka shqyrtuar vetëm ato pretendime që lidhen me atë pjesë të vendimit të saj që ka disponuar për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e cila është bërë përfundimtare. Në këtë këndvështrim shumica në vlerësim të thelbit të pretendimeve, duke marrë në konsideratë faktin se kjo çështje është rigjykuar nga Gjykata e Lartë në bazë të vendimit të Gjykatës nr. 70/2017, ka çmuar ta trajtojë atë të lidhur me standardin kushtetues të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të kësaj Gjykate (*shih paragrafin 29 të vendimit*). Më tej, ajo ka arsyetuar se pretendimet me natyrë kushtetuese jo vetëm gjejnë pasqyrim në vendimin objekt kundërshtimi, por ato janë analizuar dhe vlerësuar prej Gjykatës së Lartë brenda kufijve të diktuar nga ligji, në kushtet kur ajo nuk mund të çmojë provat për sa i përket themelit dhe fuqisë provuese të tyre. Po kështu, shumica ka evidentuar vlerësimin që Gjykata e Lartë u ka bërë pretendimeve të kërkuesit për parimet e prezumimit të pafajësisë dhe moszbatimit të ligjit penal favorizues, duke konkluduar se Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 70/2017 i Gjykatës dhe se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit, të lidhur me standardin kushtetues të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të kësaj Gjykate, është i pabazuar, pasi vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë alogjik dhe të ketë kundërthënie, si dhe plotëson kërkesat për respektimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, ndërsa pjesa e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 47 dhe 48 të vendimit*).

5. Në ndryshim nga shumica çmojmë se vendimi i kundërshtuar duhet të konsiderohej përfundimtar për dy arsye: (i) vendimi gjyqësor i ka dhënë shkak të drejtpërdrejtë pretendimeve të

kërkuesit për cenimin e të drejtave themelore, në kuptimin që kërkuesi nuk ka ndonjë mjet efektiv për t'u ankuar ndaj këtij vendimi dhe të drejtat e cenuara nuk mund të rivendosen nga rigjykimi i çështjes; (ii) çështja gjyqësore, për të cilën është dhënë vendimi i kundërshtuar, ka në themelin e saj fakte, të cilat nuk mund të ndahen nga njëri-tjetri. Për sa i përket themelit të çështjes, vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si pjesë e procesit të rregullt ligjor i lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë, që garantohen nga nenet 42, 142, pika 1 dhe 30 të Kushtetutës, është i bazuar, për rrjedhojë kërkesa duhet të ishte pranuar.

6. Sikurse thekson shumica, jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Nën dritën e standardeve kushtetuese dhe rrethanave të çështjes konkrete vlerësojmë se paraprakisht Gjykata e Lartë, në zbatim të parimit të subsidiaritetit për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, duhet të mbante në konsideratë parashikimet e nenit 93, pika 1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit ndarja e çështjeve mund të bëhet vetëm kur nuk dëmtohet vërtetimi i fakteve dhe kur për një ose më shumë akuza hetimi gjyqësor është i plotë, kurse për akuzat e tjera është e nevojshme të kryhen veprime të tjera, me përjashtim të rastit kur akuza është ngritur për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim. Kjo dispozitë në vetvete, duke përcaktuar pengesë ligjore për Gjykatën e Lartë për të ndarë çështjen, mbron parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë.

8. Për sa më lart, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se Gjykata e Lartë, në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata me vendimin nr. 70/2017, mund ta caktonte vetë dënimin për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”. Një gjë e tillë përputhet edhe me praktikën e mëparshme të ndjekur prej saj, ku ajo vetë ka bërë individualizimin e masës

së dënimit, duke mbajtur parasysh që rrethanat për caktimin e masës së dënimit, sipas nenit 47 të KP-së, janë përcaktuar nga pikëpamja faktike nga gjykatat e faktit në bazë të provave të administruara dhe vlerësuara gjatë shqyrtimit në themel të çështjes. Në të tilla raste Gjykata e Lartë, pa i hyrë vlerësimit të provave dhe fakteve, ka vlerësuar se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme për sa i përket masës së dënimit ka qenë i gabuar (*shih vendimet 00-2017-41 (7), datë 08.02.2017; 00-2017-42 (8), datë 08.02.2017; 00-2017-44 (11), datë 08.02.2017; 00-2017-44 (11), datë 08.02.2017; 00-2017-45 (12), datë 08.02.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Në këtë pikë evidentojmë, gjithashtu, se jo pa qëllim Gjykata me vendimin e saj të mëparshëm të vitit 2017 e ka kthyer këtë çështje për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë. Nëse Gjykata do të kishte vlerësuar se gjykata kompetente për rigjykimin e çështjes do të ishte gjykata e zakonshme, ajo do ta kishte kthyer çështjen në gjykatën e apelit. Fakti që Gjykata ka vlerësuar se riparimi i shkeljes duhet të bëhet nga Gjykata e Lartë, qartësisht ka të bëjë me faktin se individualizimi i dënimit lidhet me zbatimin e ligjit, dhe jo me vlerësimin e provave.

9. Në vijim të sa më sipër, ne gjyqtarët në pakicë, çmojmë se arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë ka cenuar edhe parimin e prezumimit të pafajësisë, i cili, sipas jurisprudencës së Gjykatës, kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimin nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 12, datë 24.08.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, ashtu sikurse u përmend më lart, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta e kanë shteruar plotësisht procesin e të provuarit, duke administruar dhe vlerësuar në përputhje me ligjin procedural penal të gjitha provat me dëshmitarë, si dhe ato shkresore, të paraqitura në funksion të procesit penal. Për pasojë, vendimi i fajësisë për kërkuesin, lidhur me dy akuzat në ngarkim të tij, nuk është në kufirin e dyshimit të arsyeshëm. Ajo gjykatë ka theksuar se një nga institutet më të rëndësishme të së drejtës procedurale penale është ai i “provave dhe procesit të të provuarit”. Rëndësia e shqyrtimit dhe e verifikimit të provave gjatë gjyqimit të çështjes është përcaktuese për formimin e bindjes së brendshme të gjykatës, mbi bazën e së cilës do të përcaktohet vërtetësia dhe fuqia e tyre provuese (*shih paragrafin 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

11. Pavarësisht këtij arsytimi, kjo gjykatë, duke vendosur në dispozitiv prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim për sa i përket deklarimit fajtor të kërkuesit për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, krijon përshtypjen se gjykata e apelit mund të përsërisë edhe një herë procesin e të provuarit të fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, çka nuk përjashton edhe deklarimin e tij të pafajshëm për këtë vepër penale. Një gjë e tillë do të krijonte një situatë jologjike, nisur nga fakti se kërkuesi është dënuar për veprën penale të vrasjes, e cila është kryer me armën luftarake. Nga ana tjetër, nisur nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë duket se, ashtu sikundër pretendon edhe kërkuesi, gjykatës së apelit i ngelet vetëm përcaktimi i masës së dënimit në lidhje me këtë vepër penale, çka, në vlerësimin tonë, krijon paqartësi për detyrat që i janë lënë gjykatës së rigjyimit nga gjykata më e lartë. Po kështu, kthimi i çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, në rastin konkret, për sa kohë që, ashtu siç parashtruam më sipër, Gjykata e Lartë kishte të gjitha hapësirat ligjore që ta zgjidhte vetë çështjen vetëm në drejtim të caktimit të masës së dënimit, vlerësojmë se ndikon edhe në tejzgjatjen e afatit të gjyqimit të çështjes së kërkuesit, duke vënë në rrezik edhe një të drejtë tjetër kushtetuese të tij, gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, si një nga aspektet e së drejtës për proces të rregullt.

12. Në përfundim, për sa kemi parashtruar më sipër, vlerësojmë se ankimi kushtetues i kërkuesit ishte i bazuar dhe, si i tillë, ai duhej të pranohej dhe Gjykata duhej të vendoste shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

Anëtarë: Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari